



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË		UNIVERSITETI UNIVERZITET "HAXHI ZEKA" PEJË
REKTORATI		
No./Dn./No.	2846	Nr. lfaq./Borr./No. pg. 2
Data / Datum / Date:	14/11/2025	

UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET
"HAXHI ZEKA"

Zyra Për Burime Njerëzore dhe Barazi Gjinore

Pejë, ____ .11.2025

Mbështetur në nenin 36 [Praktikantët] të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 08/L-294, nenin 16 [Praktikantët] të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës dhe nenin 13 të Statutit Nr. 04-V-622, datë 30.5.2013, Universiteti "Haxhi Zeka" në Pejë, shpall:

KONKURS
për pranimin e njëzet (20) praktikantëve në administratën e UHZ

Informatat e përgjithshme:

Universiteti "Haxhi Zeka" në Pejë (UHZ), ofron mundësi për praktikë profesionale me pagesë për studentë aktivë dhe të diplomuar të njësive të tij akademike. Qëllimi kryesor i praktikës profesionale është zbatimi i njohurive teorike të kandidatëve në ambiente reale pune, në fusha të ndryshme profesionale dhe administrative.

Për këtë qëllim, UHZ ofron mundësi angazhimi të njëzet (20) praktikantëve (studentë aktivë dhe të diplomuar) nën kushtet dhe kriteret si në vijim:

Lartësia e pagesës:	250 euro (bruto) në muaj;
Orari:	Fleksibil, në koordinimin me menaxherin e linjës;
Kohëzgjatja:	Gjashtë (6) muaj për studentët aktivë, respektivisht një (1) vit për të diplomuarit;
Periudha e angazhimit:	Studentët aktivë: 8.12.2025 – 7.6.2026; dhe Të diplomuarit: 8.12.2025 – 7.12.2026.

Fusha e realizmit të praktikës do të caktohet pas përzgjedhjes, gjegjësisht në vartësi prej profilit të studimeve të kandidatit, si dhe nevojave operative dhe strategjike të Universitetit.

Praktikantit, pas përfundimit me sukses të programit të praktikës, i lëshohet një certifikatë nga Universiteti, si dëshmi për përvojën e fituar.

Kriteret për aplikim:

- Kandidati për punë praktike duhet të jetë student aktiv ose duhet t'i ketë kryer studimet në njërin prej njësive akademike të UHZ-së;
- Përparësi do të kenë kandidatët që nuk kanë përfituar nga programet e mëparshme të praktikës në UHZ, institucionet ose organizata të tjera;
- Për qëllime të plotësimit të numrit të vendeve të punës praktike, sipas nevojës, UHZ do të organizojë një intervistë të shkurtër me kandidatët e interesuar.

Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim:

- Letër motivuese (për të gjithë kandidatët);
- Vërtetimi për statusin e studentit (vetëm për studentët aktivë);
- Pasqyra e notave (vetëm për studentët aktivë);
- Kopja e noterizuar e diplomës së lëshuar nga UHZ (vetëm për të diplomuarit).

Afati dhe mënyra e aplikimit:

- **Afati për aplikim:** Afati për aplikim nga kandidatët e interesuar do të jetë i hapur tetë (8) ditë kalendarike nga dita e shpalljes nga Zyra për Burime Njerëzore dhe Barazi Gjinore ueb faqen e UHZ-së, gjegjësisht nga data 18.11.2025 deri me 25.11.2025, në orën 16:00.
- **Mënyra e aplikimit:** Kandidatët e interesuar, dokumentacionin e kompletuar duhet të dërgojnë në formë elektronike në adresën zyrtare elektronike apliko.online@unhz.eu. Aplikacionet e pasaftshme nuk pranohen për shqyrtim, ndërsa ato të mangët refuzohen.